



Skema e Granteve "IPARD-Like" bashkëfinancohet nga BE-ja dhe Qeveria Shqiptare dhe zbatohet nga GIZ dhe AZHBR

## THIRRJA E DYTË PËR DORËZIMIN E APLIKIMEVE "IPARD-like" nr. 02/2013

në përputhje me Marrëveshjen e Delegimit të BE-së nr. 2012/295-403

Agjencia e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural (AZHBR) e Shqipërisë në bashkëpunim me Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) shpallin **Thirrjen e Dytë për Dorëzimin e Aplikimeve të Skemës së Granteve "IPARD-like" 2012 – 2014 për zhvillimin e sektorit agro-shqimor në Shqipëri.**

**Thirrja e 2<sup>të</sup> do të qëndrojë e hapur nga data 30 Prill 2013 deri në datën 14 Qershor 2013, ora 16:30, me orën lokale.**

Skema e Granteve "IPARD-like" zbatohet në kuadër të Projektit EU-IPA 2011 "Mbështetje për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural" (SARD). Skema e Granteve bashkëfinancohet nga BE-ja (75%), me GIZ si Autoritet Kontraktues dhe nga Qeveria Shqiptare (25%), me AZHBR-në në rolin e Autoritetit Kontraktues. Buxheti i përgjithshëm në dispozicion të granteve pavarësisht nga numri i thirrjeve është **8.270.000 EURO kontribut public**, nga të cilat 6.200.000 EURO janë kontribut i Komunitetit dhe 2.070.000 Euro janë nga kontributi Kombëtar.

Thirrja është e hapur për të gjithë personat (persona fizik dhe juridikë) puna dhe veprimtaria e të cilëve zhvillohet brenda territorit të Republikës së Shqipërisë në fushat e prodhimit bujqësor ose të agro-përpunimit; në sektorët e qumështit, mishit, frutave dhe perimeve.

Aplikimet mund të dorëzohen në lidhje me dy Masa:

**Masa 1 Investime në fermat bujqësore**

**Masa 2 Investime në përpunimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore.**

Në lidhje me Thirrjen e 2<sup>të</sup>, do të zbatohen **vetëm kushtet dhe formatet e dokumenteve që gjenden brenda Udhëzuesit të ri për Aplikantët (versioni 2.0)**. Udhëzuesi i ri mund të shkarkohet nga faqet e internetit [www.azhbr.gov.al](http://www.azhbr.gov.al) dhe [www.IPARD-like.al](http://www.IPARD-like.al).

Afati i fundit i përfundimit të zbatimit të projekteve të investimeve dhe i dorëzimit të kërkesës për pagesë është data 31 Janar 2014.

**Shpërndarja paraprake** e fondeve sipas masave është:

Masa 1 – 62%

Masa 2 – 38%

**Totali i shpenzimeve të pranueshme për secilin aplikim është (projekt investimi):**

**Për Masën 1:**

- **shuma minimale: 2,500 EURO;**
- **shuma maksimale: 150,000 EURO.**
- **Për aplikimet me mbi 150,000 EURO të totalit të shpenzimeve të pranueshme dhe deri në 300,000 EURO do të zbatohet rregulli i mëposhtëm:**

Në rastin kur aplikimi do ta tejkalojë shumën maksimale të totalit të shpenzimeve të pranueshme të projektit të investimit prej 150,000 EURO, deri në nivelin prej 300,000 EURO të totalit të shpenzimeve të pranueshme, atëherë ai do të kontraktohet vetëm në rast se do të ketë buxhet të disponueshëm dhe të gjitha kriteret e tjera do jenë përmbushur (kriteret e përzgjedhjes dhe pranueshmërisë, përfshirë ato të renditjes).

**Për Masën 2:**

- **shuma minimale: 20,000 Euro**
- **shuma maksimale: 500,000 EURO**



Skema e Granteve "IPARD-Like" bashkëfinancohet nga BE-ja dhe Qeveria Shqiptare dhe zbatohet nga GIZ dhe AZHBR

- **Për ato aplikime me mbi 500,000 EURO të totalit të shpenzimeve të pranueshme dhe deri në 1,000,000 EURO do të zbatohet rregulli i mëposhtëm:**

Në rastin kur aplikimi do të tejkalojë shumën maksimale të totalit të shpenzimeve të pranueshme të projektit të investimit prej 500,000 EURO, deri në nivelin prej 1,000,000 EURO të totalit të shpenzimeve të pranueshme, atëherë ai do të kontraktohet vetëm në rast se do të ketë buxhet të disponueshëm dhe të gjitha kriteret e tjera do jenë përmbushur (kriteret e përzgjedhjes dhe të pranueshmërisë, përfshirë ato të renditjes).

**Mbështetja e sektorit publik për përfituesit do të jepet deri në masën 50% të totalit të kostove të pranueshme dhe do të paguhet vetëm pas përfundimit të investimit.**

Për **Masën 1**, përqindja e rimbursimit për investimet do të jetë më e lartë nëse përmbushen kriteret e mëposhtme:

- 55% për fermerët e rinj (nën 40 vjeç), 60% për ato në zonat malore siç parashikohet edhe nga rregulloret e vendit, dhe 65% për ato investime të bëra në zona malore nga fermerë të rinj.

Të gjitha palët e interesuara janë të lutura të konsultojnë **Udhëzuesin e ri për Aplikantët** (versioni 2.0) lidhur me kriteret e pranueshmërisë, llojet e investimeve të pranueshme, përgatitjen e aplikimeve dhe rregullat e dorëzimit të aplikimeve për projektet e investimeve. Udhëzuesi i ri dhe formatet zyrtare të dokumenteve që duhet të përdoren (formulari i aplikimit, plani biznesit) mund të **shkarkohen** nga faqet e internetit [www.azhbr.gov.al](http://www.azhbr.gov.al) dhe [www.IPARD-like.al](http://www.IPARD-like.al)

**Kopjet e printuara** (falas) të **Udhëzuesit të ri për Aplikantët** (versioni 2.0) mund të gjenden në zyrat e AZHBR-së në MBUMK, Sheshi Skënderbej nr.2, Tiranë, si dhe në Drejtoritë Rajonale të Bujqësisë (RDA) gjatë orarit zyrtar të punës.

Datat dhe vendet e sesioneve **informuese / të trajnimit** për këtë thirrje mund të gjenden ne faqet e mësipërme të internetit.

**Të gjitha Aplikimet duhet të dorëzohen të printuara vetëm në zyrat qendrore të AZHBR-së në Tiranë, në një zarf të mbyllur me shënimin sipër "TË MOS HAPET PËRPARA DORËZIMIT – DORËZUAR PËR THIRRJEN E APLIKIMEVE "IPARD-like" nr. 02/2013". Zarfi me aplikimin mund të dorëzohet** dorazi personalisht, përmes shërbimit të dërgesave ose përmes postës rekomande në adresën:

Agjencia e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural  
Sheshi Skënderbej nr.2  
1001 Tiranë, Shqipëri

duke shënuar gjithashtu masën për të cilën dorëzohet aplikimi së bashku me të gjitha dokumentet e tjera shoqëruese, siç tregohet në Udhëzuesin për Aplikantët.

#### **Shënim për aplikantët potencialë:**

Aplikimet e dërguara në mënyra ose në adresa të tjera nuk do të pranohen.

Aplikimet e dorëzuara apo të marra pas skadimit të afatit përfundimtar do të skualifikohen automatikisht.

Aplikimet e dorëzuara pa formatin e kërkuar të Formularit të Aplikimit do të skualifikohen automatikisht.

Aplikimet e dorëzuara pa formatin e kërkuar të Planit të Biznesit do të skualifikohen automatikisht.

#### **Për më shumë informacion kontaktoni:**

##### **AZHBR:**

Tel: +355 (0) 422 48 208

Email: [info@azhbr.gov.al](mailto:info@azhbr.gov.al)

##### **GIZ :**

Tel: +355 (0) 422 27 568

Email: [SARD-IPARD@giz.de](mailto:SARD-IPARD@giz.de)